

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot në datën 02/04/2024, në Bashkin Belsh, në procesin e "Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor Belsh".

Morën pjesë në takim: Drejtori i Urbanistikës Ndriçim Rreka, Përgjegjësi i urbanistikës Vullnet Idrizi, punonjës dhe qytetarë të Bashkisë Belsh.

Rendi i ditës: "Rishikimi i Planit të Përgjithshëm Vendor Belsh"

Takimi u hap me fjalimin e mbajtur nga Drejtori i Urbanistikës i cili falenderoi të gjithë pjesëmarrësit në takim dhe duke i ftuar të jenë pjesë e diskutimit duke dhënë komentet, sugjerimet dhe pyetjet e paqarta që ata kanë rreth kësaj nisme që po ndërmerr bashkia.

Më pas fjalën e mori Përgjegjësi i Urbanistikes i cili bëri prezantimin e kësaj nisme dhe ndryshimet qe do të bëhen në Planin e Përgjithshëm Vendor, duke i pasqyruar këto ndryshime edhe në disa dokumenta të cilat iu shpërndan pjesëmarrësve. Më pas iu dha fjalë pjesëmarrësve të tjerë për tu bërë pjesë e diskutimit dhe për të bërë pyetjet që ata kanë.

Disa nga nga pyetjet që u bënë ishin:

1-Çfarë tregon Përqindja e Përdorimit e ilustruar në grafikët e dhënë në dokumentat e përdorura gjatë këtij takimi?

2-Nisma e ndërmarrë i përket vetëm Bashkisë Belsh apo është një nismë e ndërmarrë edhe në bashki të tjera?

3-Si ndikon ky ndryshim i planit tek banorët e zones?

Pas diskutimit dhe kthimit të përgjigjeve për pyetjet e bëra nga qytetarët, takimi u mbyll me një falenderim për të gjithë pjesëmarrësith <https://www.aie-albania.tech/analist-te-dhenash>.